



Verein VIELE

Verein für interkulturellen Ansatz
in Erziehung, Lernen
und Entwicklung

Rainerstr. 27/I. Stock
5020 Salzburg
Tel: 0662/870211
Fax: 0662/886399
office@verein-viele.at
www.verein-viele.at

Ofertat e qendrës

Qendra interkulturore për gra dhe vajza

Ne ofrojmë vendtakim për femra me këto qëllime: mundësinë e mësimin të gjuhës gjermane, kurse për analfabete, mbrëmje kulturore, informata si dhe mundësi që femrat nga kulturat dhe vendet e ndryshme të shoqërohen mes veti.

Ne ju ofrojmë një vend të sigurt për të gjitha femrat, si nga kulturat ashtu edhe nga religionet e ndryshme. Fëmijët janë po ashtu të lejuar në qendrën tonë, ata mund të luajnë dhe të ndihen si në shtëpinë e tyre.

Femrat mund të zgjedhin vetë se cilat nga kurset dëshirojnë t'i ndjekin. Ato bashkë me ndihmën e personelit tonë vijojnë kurset të cilat i preferojnë vetë.

Kurset e gjuhës gjermane

Ne ju ofrojmë femrave mundësinë të ndjekin kurse që nga ato të shkallës fillestare deri tek ato të nivelit më të lartë.

Përderisa mësojnë gjuhën gjermane ato mësojnë edhe si të bëjnë pazar, si të shkojnë në vizita te mjeku, bisedat në lidhje me shkollimin, mësojnë qendra për punësim si dhe qendra të ndryshme për shërbime të tjera. Ato mësojnë se si të kryejnë obligimet ditore në mënyrë të pavarur, d.m.th. të kryejnë obligimet jetësore pa ndihmën e një personi tjetër.

Kurset për integrim në gjuhën gjermane

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri (me 1.1.1998), i cili thotë se për kërkesën e parë të lejes së qëndrimit nevojitet vërtetimi për vijimin dhe certifikimin për gjuhën gjermane, ne ofrojmë kurse që janë të pranuar dhe të mbështetura nga shteti.

Kurset për analfabete

Të lexuarit dhe të shkruarit nuk është i kuptueshëm për të gjitha gratë. Për të zvogëluar këto probleme ne ofrojmë kurse të veçanta në të cilat mësohet si të tejkalohen problemet e këtyra dhe më lehtë të kryhen obligimet e ditës.

Kreativiteti

Shumë gra për shkak të kushteve jo të mjaftueshme, nuk kanë mundësi të takohen me njëra-tjetrën, të shoqërohen dhe ndajnë përvojat dhe të flasin për problemet e lidhura me fëmijët apo punën. Andaj, ne u ofrojmë mundësinë që në objektet tona ato të takohen dhe shoqërohen, si dhe shqyrtojmë kërkesat e ndryshme të grave dhe mundohemi t'i koordinojmë dëshirat e ndryshme të tyre.

Integrimi dhe kultura

Ne ofrojmë gjithashtu edhe kurse të tjera të rregullta si dhe organizime në të cilat gratë informohen dhe edukohen për kulturën vendore, mënyrën e jetesës si dhe ligjet, me qëllim që të integrohen më lehtë.

Festat

Vajzat dhe gratë duhet të kenë mundësitë të festojnë festat tradicionale së bashku, gjithashtu edhe gratë vendase marrin pjesë shumë herë në këto takime festive.

Dita e dyerve të hapura

Çdo të enjte që nga ora 11.30 deri në ora 14.00 dyert janë të hapura për gratë dhe vajzat pa pasur ndonjë qëllim të caktuar. Mysafirët janë gjithnjë të mirëseardhur.

Ndihmë gjatë mësimit

Nxënësit e shkollave fillore e kanë të vështirë mësimin, ngase gjuha gjermane nuk është gjuhë e tyre amtare. Prindërit nuk mundën t'ju japin ndihmën e duhur rreth detyrave të shtëpisë. Ndonjëherë ata janë të zënë me punë, e ndonjëherë edhe nuk e përvetësojnë gjuhën gjermane aq sa duhet që t'ju ndihmojnë fëmijëve, ose edhe nuk e njohin sistemin shkollor të vendit.

Për këta fëmijë ofrojmë ndihmë gjatë mësimit në formë të ndihmës gjatë kryerjes së detyrave si dhe në sferat e tjera të kohës së lirë. Në këtë formë të ndihmës janë të përfshirë edhe mësimi dhe përforcimi i gjuhës gjermane - gati gjatë gjithë kësaj kohe ata flasin vetëm në gjuhën gjermane.

Koha për zbavitje përmban edhe vizitat e ndryshme në shfaqje teatrale, rekreacione sportive si dhe lojëra dhe vizatime të ndryshme.

Konsultime familjare

Konsultimet tona përmbajnë tema të ndryshme të këtyre sferave:

Pyetje ose probleme fizike si p.sh. shtatzënia, pyetje të ndryshme mjekësore, informata rreth terapive alternative etj.

Probleme bashkëshortore, sidomos për çiftet me kultura të ndryshme!!!

Ndihmë gjatë ndarjeve dhe shkurorëzimeve.

Informata juridike dhe konsultime gjatë ndarjeve dhe shkurorëzimeve, si dhe informata për statusin e qëndrimit dhe lejes së punës mbas ndarjes me partnerin, si dhe shumë pyetje tjera juridike.

Ndihmë gjatë takimeve me qendra të ndryshme

Refugjatët dhe problemet

Problemet me gjuhën

Shkollimi dhe studimet e larta

Konsultime në punë si dhe ndihmë gjatë kërkimit për banim.

Të gjitha ofertat tona vlejnë për vajzat dhe gratë, si ato vendase po ashtu edhe nga vendet tjera.